

VENDIM
Nr.148 datë 4.5.1992

PËR KOMPETENCAT E DHËNIES SË TË DREJTËS SË STUDIMIT NË SHKOLLAT E LARTA

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranimi i studentëve në shkollat e larta në sistemin e ditës dhe në atë me korrespondencë të jetë në kompetencë të këtyre shkollave.
2. Pranimi i studentëve dhe i pasuniversitarëve me shtetësi të huaj në shkollat e larta të jetë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit.
3. Zgjedhja e studentëve që do të pranohen në shkollat e larta, si rregull të bëhet me konkurs. Pjesëmarrja në konkurs për çdo degë të shkollës së lartë të bëhet pavarësisht nga profili dhe rezultatet e mbarimit të shkollës së mesme.
4. Për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Arsimit të nxjerrë udhëzimin përkatës dhe, mbi bazën e kapaciteteve të shkollave të larta, të caktojë çdo vit numrin e studentëve që do të pranohen në çdo degë e profil.
5. Çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi